



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:083632
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05424484

Pml.nr.705/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve: L. I. dhe B. Sh., që të dy nga F. K., secili veç e veç për shkak të veprës penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*”, nga neni 422, paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të Kodit të Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.11/2019, të datës 07.07.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.488/2023, të datës 11.10.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve: L. I. dhe B. Sh., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.11/2019, i datës 07.07.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.488/2023, i datës 11.10.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.11/2019, të datës 07.07.2023, të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., secili veç e veç, janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*”,

nga neni 422, paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe ndaj secilit prej të dënuarve, është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga një (1) vit, të cilat dënime do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në pajtim me nenin 62 lidhur me nenin 66 të KPRK-së, ndaj të dënuarve: L. I. dhe B. Sh., është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve, duke llogaritur nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, kurse koha e kaluar në mbajtje të dënimit me burgim ose në institucionin e kujdesit shëndetësor, nuk llogaritet në kohëzgjatje të këtij dënimi.

Janë anuluar veprimet juridike të regjistrimit të personave të cekur në pikat I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit me shtetësi të Republikës së Kosovës dhe në regjistrat e gjendjes civile, si dhe këto të dhëna do të fshihen nga sistemi i gjendjes civile, kurse çdo dokument i lëshuar për këta persona shpallet i pavlefshëm, pasi që këto veprime - regjistrime janë rezultat i veprës penale.

Të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., janë detyruar që secili veç e veç t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga njëqind (100) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej nga pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.488/2023, e datës 11.10.2023, me rastin e ankesave të mbrojtësve të të dënuarve: L. I. dhe B. Sh., si dhe sipas detyrës zyrtare, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprave penale dhe dënimeve plotësuese, ashtu që në veprimet e të dënuarve është konstatuar se qëndrojnë elementet e veprës penale "*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*", nga neni 422, paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa sa i përket dënimeve plotësuese, ndaj të dënuarve është shqiptuar dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve, të cilat dënime fillojnë të ekzekutohen, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, ndërsa koha e kaluar në mbajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në periudhën e dënimit plotësues. Pjesa tjetër e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me: dënimet me burgim në kohëzgjatje prej nga një (1) vit për secilin të dënuar, anulimin e veprimeve juridike, shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike kanë mbetur të pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit L. I., avokati Shemdi Bunjaku, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të lirive dhe të drejtave të njeriut të parapara me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke propozuar që të ndryshohen aktgjykimet e lartcekura, ndërsa i dënuari të lirohet nga akuza

ose këto aktgjykime të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, si dhe

- mbrojtësi i të dënuarit B. Sh., avokati Imer Beka, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që aktgjykimet e lartcekura të ndryshohen, ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo këto aktgjykime të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresat KMLP.II.nr.418/2023, e datave 03.01.2024 dhe 18.01.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve L. I. dhe Bejtullah Shala, të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë të gjitha shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoi se:

- kërkesat janë të pabazuara.

Mbrojtësi i të dënuarit L. I., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal, në radhë të parë, për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh fare rrethanat se si i dënuari ka bërë regjistrimin e personave në regjistrat e gjendjes civile, si dhe nuk është treguar fare se cili ishte përfitimi i këtyre personave, pasi të njëjtëve i është anuluar veprimi juridik i regjistrimit dhe nuk është paraqitur asnjë fakt i vetëm se i dënuari ta ketë bërë regjistrimin me qëllim të përfitimit për personin tjetër.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ligjor për t'i ftuar një nga një qytetarët të cilët janë regjistruar në regjistrat e gjendjes civile, për të sqaruar bazën për të cilën këta persona e kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, sepse të njëjtit kanë pasur arsye për të aplikuar për regjistrim, duke qenë të bindur se posedojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për marrjen e shtetësisë, si dhe nuk janë vërtetuar librat amzë të regjistrimit të gjendjes civile dhe nuk janë marrë parasysh fare edhe deklaratimet e të dënuarit, i cili kishte treguar për secilin person që e ka regjistruar.

Gjithashtu, mbrojtësi i të dënuarit thekson se gjykatat e instancave më të ulëta nuk i kanë paraqitur për secilin person të regjistruar në mënyrë të drejtë dhe të saktë, faktet apo rrethanat tjera të cilat është dashur të përmbushen, në mënyrë që të njëjtit ta fitojnë shtetësinë sipas Ligjit për Shtetësinë e Kosovës dhe se bazuar në këtë ligj, të gjithë personat e regjistruar i kanë plotësuar kushtet për fitimin e shtetësisë. Në anën tjetër, nuk është marrë për bazë puna e të dënuarit, të cilin si zyrtar të gjendjes civile e kontrollon inspeksioni i Agjencisë së Regjistrimit Civil, ku herë pas here, gjatë kontrollimit të dosjeve, i dënuari e ka bërë regjistrimin e këtyre personave dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje, përveç një vërejtje që i kanë bërë për një person i cili nuk është përfshirë në aktakuzë, pasi

që të njëjtit i është refuzuar shtetësia. Të gjitha këto që u theksuan më lart, sipas mbrojtësit të të dënuarit përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke pretenduar me këtë rast se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 të KPP-së dhe se gjykata në fjalë ka vepruar në kundërshtim me nenin 360 dhe nenin 3, paragrafi 2 të KPP-së, kur ka vendosur që i dënuari të shpallet fajtor për shkak të veprës penale për të cilën ishte akuzuar.

Përveç shkeljeve të lartcekura, mbrojtësi i të dënuarit L. I. pretendon se në këtë rast, me aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta është shkelur edhe ligji penal në dëm të të dënuarit, pasi që ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale dhe rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale, si dhe nuk është arritur që të vërtetohet se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën është shpall fajtor, sepse i dënuari ka vepruar vetëm sipas ligjit dhe se nuk ka bërë asnjë veprim me qëllim të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Mbrojtësi i të dënuarit B. Sh., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369, paragrafët 7 dhe 8 të KPP-së, se i njëjti është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në mes të asaj çka paraqitet në dispozitiv dhe në arsyetim. Në këtë mënyrë, në dispozitiv të aktgjykimit të lartcekur thuhet: “... i ka regjistruar në sistemin qendror të gjendjes civile, edhe pse të njëjtëve iu është refuzuar shtetësia nga DShAM-ja...”, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit nuk është provuar me asnjë provë materiale, se diçka e tillë ka ndodhur, përkatësisht që i dënuari më parë të ketë qenë i njoftuar për këtë, në çfarëdo mënyre. Gjithashtu, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë marrë për bazë edhe mungesën e informacioneve të rregullta dhe të vazhdueshme për ndryshimet e shpeshta të dispozitave ligjore lidhur me regjistrimin civil, kurse në anën tjetër, në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë përfshirë të dhënat e nevojshme, ashtu siç është parashikuar në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së.

Përveç aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse në të nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë arsyet se pse është refuzuar ankesa e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa disa arsye të paraqitura janë jo bindëse.

Po ashtu, sipas mbrojtësit të të dënuarit, në këtë çështje penale është bërë edhe shkelje e ligjit penal, pasi që duke u bazuar në nenin 422, paragrafi 1 të KPRK-së, kjo vepër penale kryhet duke tejkuluar kompetencat, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie, ndërsa në rastin konkret, nuk është provuar një gjë e tillë, siç nuk është provuar as përfitimi, si një prej elementeve të veprës penale, pasi që nuk është marrë deklaratë nga përfituesit, përveç disa prej zyrtarëve të Agjencionit të Regjistrimit Civil, të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore të jenë persona në cilësinë e dëshmitarëve.

Mbrojtësi i të dënuarit, pretendon se bazuar me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është arritur që të vërtetohet as dashja e të dënuarit për kryerjen e veprës penale, ndërsa duke u bazuar në rrethanat e rastit konkret, gjykatat e instancave më të ulëta është dashur që ta zbatojnë parimin “*In Dubio Pro Reo*”, nga neni 3 të KPP-së, pasi që për lëshimet apo gabimet e pa qëllimshme të lëshuara gjatë punës për shkak të njohurive të pa mjaftueshme dhe ndryshimeve të vazhdueshme të dispozitave ligjore që e rregullojnë shërbimin civil, ka mundur që eventualisht të zhvillohet procedurë disiplinore.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë pretendimet e lartcekura të mbrojtësve të të dënuarve: L. I. dhe B. Sh., konstatojë se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Fillimisht, duhet theksuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është hartuar sipas nenit 369 të KPP-së, andaj edhe pretendimi i mbrojtësve në këtë drejtim është i pabazuar, për arsytet që do të paraqiten në vijim.

Siç është paraqitur edhe më parë, dy (2) çështje diskutabile të cilat ka përmbajtur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë që ndërlidhen me cilësimin juridik të veprave penale dhe shqiptimin e dënimeve plotësuese janë evituar nga gjykata e shkallës së dytë dhe atë: çështja e “veprës penale të vazhduar”, ku me të drejtë është konstatuar nga gjykata e shkallës së dytë se në këtë rast nuk vjen në shprehje një format e tillë i veprës penale për asnjërin nga të dënuarit, si dhe çështja e dënimeve plotësuese, me ç’rast gjykata e shkallës së dytë me të drejtë ka vendosur që ndaj të dënuarve të lartcekur të duhet shqiptuar dënimin plotësues “ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik”.

Duke ju referuar pretendimeve të mbrojtësve, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten dhe gjithashtu është edhe në harmoni me pjesën e arsyetimit.

Përtej kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë përshkruar në mënyrë të hollësishme veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., së bashku me faktet dhe rrethanat që i përbëjnë figurat e veprave penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*”, nga neni 422, paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal. Në këtë aspekt, nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se janë përshkruar dhe vërtetuar këto fakte dhe rrethana që i përbëjnë elementet e figurës së veprave penale të lartcekura dhe atë: koha dhe vendi i kryerjes së veprave penale; cilësia e personit zyrtar-zyrtar i gjendjes civile në komunën e Fushë-Kosovës; tejkalimi i kompetencave nga ana e të dënuarve, duke vepruar në kundërshtim me Ligjet përkatëse për Shtetësinë e Kosovës (Ligjet nr.04/L-2015 dhe

nr.03/L-034) dhe atë nenin 4, pika 3 dhe nenin 23, si dhe në kundërshtim e Udhëzimet Administrative të Ministrisë së Punëve të Brendshme (nr.17/2009 dhe nr.04/2014) për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës; mospërfillja e procedurave për fitimin e shtetësisë, pa pasur vendim për fitimin e shtetësisë; qëllimi i përfitimit për personat tjerë; regjistrimi i personave tjerë në regjistrat e gjendjes civile, edhe për personat të cilëve me vendim përkatës të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion të Ministrisë së Punëve të Brendshme i është refuzuar shtetësia dhe të dhënat e personave të cilëve i është mundësuar fitimi i shtetësisë, ndërsa të gjitha këto rrethana dhe fakte janë përshkruar në mënyrë të veçantë për secilin nga të dënuarit (pikat I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit).

Në këtë mënyrë, rezulton se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, tek pjesa e përshkrimit të veprimeve kryerëse janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë të gjitha rrethanat dhe faktet e nevojshme të cilat i përbëjnë elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., kështu që edhe pretendimet e mbrojtjes edhe në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson si të pabazuar edhe pretendimin e mbrojtjes se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është në kundërtënie me pjesën e arsytimit.

Në anën tjetër, në arsyetimin e këtij aktgjykimi shihet qartë që janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së dhe se përshkrimet e dhëna në arsyetim, përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërtënëse.

Përveç shumë aspekteve tjera të rëndësishme, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të mjaftueshme arsye, si për faktet kontestuese, ashtu edhe për ato jo kontestuese.

Në këtë drejtim, tre (3) çështje apo pyetje kanë qenë objekt i shqyrtimit dhe arsytimit të veçantë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe atë:

- 1) A është bërë regjistrimi i personave në pajtim me ligjin?
- 2) A i kanë tejkalluar kompetencat e tyre të dënuarit: L. I. dhe B. Sh.? dhe
- 3) Regjistrimi i kundërligjshëm i personave nga të dënuarit e lartcekur, a është bërë me dashje?

Për të gjitha këto çështje apo pyetje, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye dhe elaborime të mjaftueshme, nga të cilat janë nxjerrë konkluzione se regjistrimi i personave nuk është bërë në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore dhe se të dënuarit kanë tejkalluar kompetencat e tyre, kur kanë pajisur me shtetësi gjashtëdhjetekatër (64) persona, duke i regjistruar të njëjtit në mënyrë të kundërligjshme në Sistemin Qendror të Gjendjes Civile. Në këtë rast, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë shihet se tejkalimi i

kompetencave ekziston për faktin se të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., nuk e kanë zbatuar procedurën e paraparë me ligj për dhënien e shtetësisë personave të caktuar dhe kështu futjen e tyre në sistem dhe pajisjen e të njëjtëve me shtetësi, edhe pse kjo, sipas Ligjit për Shtetësi është kompetencë ekskluzive e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në vijim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur edhe dispozitat ligjore dhe udhëzimet administrative që rregullojnë procedurën e dhënies së shtetësisë dhe faktin se një gjë e tillë është kompetencë ekskluzive e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e në asnjë mënyrë e zyrave komunale të gjendjes civile. Sipas këtyre dispozitave ligjore, të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., si zyrtarë të gjendjes civile në komunën e F. K., është dashur që kërkesat e palëve t'i regjistrojnë dhe lëndët t'i përcjellin në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe jo vetë t'i pajisin qytetarët me shtetësi të Republikës së Kosovës.

Edhe sa i përket aspektit subjektiv të veprave penale, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka paraqitur arsyetime të qarta dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilat është ardhur deri tek konkludimi se në këtë rast të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., kanë vepruar me dashje dhe me qëllimin e përfitimit për personat tjerë, duke e pasur parasysh përvojën e tyre të gjatë si zyrtarë të gjendjes civile, trajnimet e tyre të vazhdueshme, njoftimet për ndryshimet ligjore nga mbikëqyrësit e tyre, etj. Nga shkresat e lëndës, shihet se një aspekt i tillë subjektiv i veprës penale është nxjerrë nga rrethanat faktike të rastit, bazuar në nenin 22 të KPRK-së dhe një gjë e tillë është përforcuar edhe më shumë nga pjesa e deklaratës së dëshmitarit L. N., i cili kishte deklaruar se ka shumë persona që tash evidentohen, që nga komunat tjera kanë shkuar dhe janë regjistruar si shtetas të Republikës së Kosovës në komunën e Fushë Kosovës, duke shtuar se është gjetur një hapësirë që në këtë komunë të kryhen ose fitohen shtetësi në mënyrë të paligjshme.

Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës e ka vlerësuar si të parëndësishëm faktin nëse të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., kanë qenë të jenë njoftuar me vendimet në lidhje me refuzimin e fitimit të shtetësisë për personat e caktuar, për faktin se nuk ka qenë fare kompetencë e tyre që t'i pajisin qytetarët me shtetësi, ngase një gjë e tillë, siç është theksuar edhe më lart, ka qenë kompetencë ekskluzive e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor janë administruar disa prova, duke përfshirë këtu: dëgjimin e dëshmitarëve: T. B., A. M., L. N., E. G. dhe Xh. P., administrimin e njëzetekatër (24) dokumenteve të ndryshme (njoftime, vendime të ndryshme, shkresa, kartonët e letërnjoftimeve të ish Republikës Federative të Jugosllavisë, etj.), ndërsa duke e pasur parasysh se të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., janë mbrojtur në heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor, atëherë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore janë vlerësuar deklaratimet e tyre të dhëna në prokurori. Ndërsa, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se në këtë rast janë vlerësuar dhe

analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së, ndërsa më pastaj, pas një procesi të tillë, janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike.

Andaj, edhe bazuar vëllimin e materialit provues, përkatësisht numrin, vlerën provuese dhe rëndësinë e deklarimeve të dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe të provave tjera materiale, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se dëgjimi edhe i dëshmitarëve tjerë apo edhe administrimi i ndonjë prove tjetër materiale është i panevojshëm, pasi që në këtë rast, nga rezultati i administrimit të këtyre provave janë nxjerrë konkluzione të caktuara që i referohen si gjendjes faktike, ashtu edhe aspekteve tjera juridike, të cilat si të tilla janë vlerësuar të drejta dhe të ligjshme, ndërsa me mos administrimin e provave tjera, në asnjë mënyrë nuk është vështirësuar gjetja e së vërtetës materiale dhe as keqësimi i pozitës juridike të të dënuarve: L. Ibrahimimi dhe B. Sh.

Përveç tjerash, përmes aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se gjykata në fjalë ka përmbushur edhe detyrimet e saj për të paraqitur arsye edhe sa i përket çështjeve tjera, referuar nenit 369, paragrafët 7 dhe 8 të KPP-së. Në këtë drejtim, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh janë konsideruara të vërtetuara, si dhe janë paraqitur arsyet në të cilat, gjykata në fjalë është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprave penale dhe përgjegjësisë penale për secilin nga të dënuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal.

Po ashtu, arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përfshin rrethanat përkatëse lehtësuese dhe rëndësuese të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimeve ndaj të dënuarve në fjalë.

Përveç këtyre që aspekteve që janë paraqitur më lart, është e rëndësishme që të theksohet, se në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur të gjithë personat që kanë fituar shtetësinë përmes veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., si dhe në këtë pjesë të aktgjykimit janë elaboruar në mënyrën e duhur dokumentet përkatëse për secilin nga këta persona.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e mbrojtësit të të dënuarit B. Sh., që ndërlidhet me parimin "*In Dubio Pro Reo*", sipas nenit 3, paragrafi 2 të KPP-së, pasi që në këtë rast nuk ekziston asnjë mëdyshje lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal. Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë shihet se janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me të gjitha aspektet relevante të kësaj çështje penale, kështu që nuk janë vërejtur mëdyshje që ndërlidhet me këtë rast apo me zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal.

Gjithashtu, edhe nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë rezulton se janë vlerësuar të gjitha pretendimet e rëndësishme ankimore të mbrojtësve të të dënuarve dhe janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket këtyre pretendimeve, por edhe sa i përket

shkeljeve tjera për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, kështu që edhe në këtë drejtim, pretendimet e mbrojtjes nuk rezultojnë të bazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës i konsideron të pabazuara edhe pretendimet në lidhje me shkeljen e ligjit penal, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta, drejtë kanë vepruar kur të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., secilin veç e veç i kanë shpallur fajtor për shkak të veprave penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*”, nga neni 422, paragrafi 1 të KPRK-së, sepse veprimet e të dënuarve në fjalë i përbëjnë të gjitha elementet subjektive (dashja dhe qëllimi) dhe objektive të këtyre veprave penale, siç është përshkruar në mënyrë të hollësishme në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Dashja dhe qëllimi i të dënuarve: L. I. dhe B. Sh., për të kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor, nga aktgjykimet e instancave më të ulëta rezulton se është vërtetuar nga rrethanat faktike të rastit, bazuar në nenin 22 të KPRK-së, për të cilën aspekt, janë paraqitur arsye më lart, tek pjesa që ndërlidhet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Në lidhje me çështjen e “dobisë” që parashihet në nenin 422, paragrafi 1 të KPRK-së, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se në këtë dispozitë ligjore nuk kërkohet në mënyrë eksplicite që “dobia” të jetë ekskluzivisht me karakter financiar, por që bazuar në këtë dispozitë ligjore, ky element i figurës së veprës penale konsiston qëllimin e kryesit për përfitimin e çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, por jo vetëm dobi me karakter financiar, ndërsa në këtë rast, për shkak të kryerjes së veprave penale nga ana e të dënuarve: L. I. dhe B. Sh., personat e përcaktuar kanë fituar shtetësinë, të cilët në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë të specifikuar me emër dhe mbiemër.

Përndryshe, është e rëndësishme të theksohet se veprat penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*”, nga neni 422, paragrafi 1 të KPRK-së konsiderohet se janë të kryera dhe të dënuarit: L. I. dhe B. Sh., janë penalisht përgjegjës për të njëjtat, pavarësisht faktit se me aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë anuluar veprimet juridike të regjistrimit të personave me shtetësi të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në nenin 422, paragrafi 1 të KPRK-së, vepra penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*”, konsiderohet se është kryer në momentin kur personi zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër, pavarësisht faktit nëse është arritur që të realizohet përfitimi i çfarëdo dobie për kryesin (personin zyrtar) apo për personin tjetër apo pavarësisht faktit nëse është shkaktuar dëm për personin tjetër apo janë shkelur seriozisht të drejtat e personit tjetër.

Mbrojtësi i të dënuarit L. I., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka specifikuar konkretisht se cilat janë ato rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të dënuarit dhe ndjekjen penale tij, ndërsa pavarësisht kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur se në këtë rast ekziston një rrethanë e natyrës së tillë.

Në fund, duhet theksuar se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë përmbajnë edhe pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, andaj edhe rrjedhimisht pretendimet e tilla nuk janë shqyrtuar fare.

Duke u bazuar në arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.705/2023, më datë 07.02.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj